AF adria ferries

# Një vazhdë emocionesh

# Index




## Ndërmarrja

6 Një vazhdë emocionesh
8 Misioni & Vizioni
10 Njësia tregtare
12 Flota
14 Shërbime në bord




## Vlerat

18 Siguria
20 Sostenibiliteti
22 Novatorizmi




## Marka

26 Një ndërmarrje e orientuar ndaj klientit
28 Sociale & Digjitale
30 Sponsorizime dhe evente
32 Njerëzit tanë
34 Ata thonë për ne



# Ndërmarrja

# ADRIA FERRIES
## Një vazhdë emocionesh




Që nga viti 2004, Adria Ferries ofron shërbimin e lidhjes detare ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë: me flotën tonë moderne të anijeve roro-pax, ne e lidhim çdo ditë Portin e Durrësit me tre portet e rëndësishme tregtare italiane të **Triestes, Ankonës dhe Barit**.

Brenda pak vitesh jemi bërë shoqëria lider e tregut në sektorin e mallrave dhe pasagjerëve të lidhjeve në aksin italiano-shqiptar, duke kontribuar në zhvillimin e tregut dhe të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

Siguria e anijeve tona, e kombinuar me profesionalizmin e personelit tonë dhe me cilësinë e shërbimeve të ofruara në bord, i bëjnë udhëtimet e pasagjerëve tonë jashtëzakonisht të rehatshme dhe relaksuese.

# Misioni

T'u garantojmë pasagjerëve tanë një **profesionalizëm maksimal**, komfort dhe siguri, për t'u ofruar atyre një përvojë udhëtimi me të gjitha shërbimet në 360 gradë.

# Vizioni

T'i ofrojmë pasagjerëve tanë shërbime gjithnjë e më të avancuara, novatore dhe të integruara, për të rritur vlerën e përvojës së tyre të udhëtimit, duke kontribuar në rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve dhe të shkëmbimeve, komerciale dhe kulturore, ndërmjet vendeve.



# Njësia tregtare

Zemra tregtare e shoqërisë ka qenë gjithmonë dega e transporteve detare. Me aktivitetet e saj, Adria Ferries plotëson nevojat e udhëtarëve që nisen dhe të transportuesve të shumtë që lëvizin mallra ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë.




**BU PASAGJERË**
Në lidhjet detare ndërmjet Italisë dhe Vendit të shqipeve, sot ne kemi strehuar në bordin e anijeve tona më shumë se 4.2 milion pasagjerë me mbi 910.000 automjetet përkatëse.

Në Adria Ferries sektori i pasagjerëve është i përbërë nga një shërbim-klienti efikas që i ndihmon vazhdimisht klientët. Përdor të gjitha kanalet që ka në dispozicionin e saj për të garantuar një shërbim të vazhdueshëm (call-center, rrjete sociale, whatsapp).

Udhëtarët tanë shoqërohen që nga çasti i rezervimit e deri në destinacion.

Reparti mbështetet në një rrjet të gjerë shitjesh online e offline, dhe është në gjendje të promovojë një gamë të gjerë shërbimesh. Komercialët, aktivë në territorin kombëtar dhe ndërkombëtar, kujdesen me ngulm për marrëdhëniet me agjencitë e udhëtimit dhe operatorët e mëdhenj të internetit.

**BU MALLRAT**
Me flotën tonë të anijeve roro-pax, ne jemi lider në tregun e lëvizjes së mallrave në aksin italo-shqiptar me rreth 160,000 njësi të transportuara në trevjeçarin e fundit. Në sajë të modernitetit dhe të teknologjisë së njësive të saj, të ndihmuara nga fleksibiliteti i hambarëve të ofruar, Adria Ferries është në gjendje të plotësojë çdo kërkesë transporti dhe të ofrojë zgjidhjet më të mira edhe për project cargo (ngarkesat e jashtëzakonshme) dhe karvanët e jashtëzakonshëm.

# Flota

## AF MARINA

Gjatësia: 168 metra
Kabina: 119 kabina
Kapaciteti: 639 persona
Garazhi: 1600 metra linear
Shpejtësia: 18 nyje







## AF CLAUDIA

Gjatësia: 186.49 metra
Kabina: 76 kabina
Kapaciteti: 1000 persona
Garazhi: 2030 metra linear
Shpejtësia: 23 nyje

## AF FRANCESCA

Gjatësia: 148 metra
Kabina: 296
Kapaciteti: 2100 persona
Garazhi: 850 metra linear
Shpejtësia: 17,5 nyje







## AF MICHELA

Gjatësia: 186.5 metra
Kabina: 78 kabina
Kapaciteti: 992 persona
Garazhi: 2040 metra linear
Shpejtësia: 23 nyje

# Shërbime në bord

Ne i konsiderojmë pasagjerët jo vetëm klientë të thjeshtë, por mysafirë në bordin e anijeve tona dhe u ofrojmë atyre shërbime cilësore të dedikuara.

**Mirëserdhët në bord**

Pas përfundimit të operacioneve të imbarkimit, pasagjerët mirëpriten nga një personel i vëmendshëm dhe profesional. Mirësjellja, profesionalizmi dhe kujdesi për mysafirët janë prioritetet e personelit tonë, që u japin mundësi pasagjerëve të ndjehen në çdo çast si në shtëpinë e tyre.

**Argëtim**

Aktivitetet argëtuese janë të shumta e të menduara për të shoqëruar pasagjerët gjatë gjithë kohës së udhëtimit (Hapësirë për fëmijët, Akullore, American snack bar, Free wifi/internet falas).

**Ushqim & Pije**

Në restorant, shefat tonë të kuzhinës përgatisin çdo ditë specialitete cilësore dhe të traditës “Made in Italy”, si rezultat i një përzgjedhjeje të kujdesshme të lëndëve të para.





# Vlerat




# Siguria

Të garantojmë sigurinë dhe mbrojtjen e udhëtarëve tanë është një pjesë integrale dhe themelore e një administrimi korrekt dhe të përgjegjshëm të biznesit.

**Siguria në bord**

Ne adoptojmë procedura pararojë për të garantuar në çdo çast respektimin e normave që mbrojnë pasagjerët dhe anëtarët e ekuipazhit në çdo kohë, duke punuar sistematikisht për të identifikuar situatat potenciale të rrezikut dhe për të përmirësuar vazhdimisht sigurinë.

**Sistemi i administrimit të sigurisë sms**

Ne parashikojmë një sistem administrimi të sigurisë që shkon përtej standardeve të thjeshta. Qasja e integruar që përdor personeli ynë nënkupton një përafrim të përsosur ndërmjet sigurisë, masave parandaluese, shëndetit dhe ambientit.

**Kanalet novatore të informacionit**

Ne investojmë në zhvillimin e instrumenteve dhe të sistemeve informative novatore që ecin me ritmin e prirjeve të komunikimit, si Safety Video që sapo është krijuar nga shoqëria jonë.




# Sostenibiliteti

"Përballë detit lumturia është një ide e thjeshtë"
***Jean-Claude Izzo***

Ne promovojmë një model biznesi të orientuar drejt zhvillimit të pranueshëm dhe krijimit të vlerës për klientët tanë dhe për ambientin.

Angazhimi ynë shkon përtej administrimit të burimeve në mënyrë të përgjegjshme, duke kontribuar konkretisht për mbrojtjen e tyre për gjeneratat e ardhshme: hulumtimi dhe zhvillimi i zgjidhjeve novatore dhe i shërbimeve të reja kalojnë nëpërmjet një procesi të realizimit të veprimeve dhe projekteve që synojnë reduktimin e ndikimit në territor, në destinacione dhe në det.

Respekti për detin dhe format e tij të jetës është në qendrën e vëmendjes së shoqërisë sonë.

# Novatorizmi

Ne u ofrojmë pasagjerëve tanë shërbime gjithnjë e më novatore dhe të integruara për të thjeshtuar dhe përmirësuar përvojën e udhëtimit në të gjitha fazat e tij.

**Procedura dhe teknologji pararojë**

Në portet e imbarkimit janë të pranishme zyra që drejtohen nga një personel i kualifikuar për të ndihmuar pasagjerët tanë në të gjitha procedurat në check-in dhe imbarkim.

Në zyrat e stacionit detar të portit të Ankonës, kemi instaluar një ledwall (ekran) prej mbi 20 metrash që informon pasagjerët në kohë reale për gjendjen e nisjeve.

Një teknologji pararojë që, për herë të parë në Itali, përdoret në një hapësirë portuale.

Aktivitetet e secilit sportel janë të diversifikuara sipas nevojave të klientit dhe ledwall-i i ri garanton koordinimin automatik për një check-in të menjëhershëm.




Zyrat e Adria Ferries për check-in në Ankona janë të vetmet që janë të pajisura me korsi preferenciale dhe sportel të dedikuar ndaj personave me lëvizshmëri të reduktuar dhe për shoqëruesit e tyre.



# Marka

# Një ndërmarrje e orientuar ndaj klientit

**Departamenti i marketingut**

Brenda ndërmarrjes është formuar një skuadër që i dedikohet Operacioneve Qendrore të Marketingut e cila merret me analizën e marketingut, kërkimin dhe zhvillimin, aktivitetet e administrimit dhe organizimin e ndërmarrjes. Një qasje gjithnjë e më e fokusuar në rritjen dhe integrimin e funksioneve të brendshme, për ta bërë Adria Ferries gjithnjë e më dinamike dhe efikase.

**Sinergjia e ndërmarrjes**

Reparti është vazhdimisht i angazhuar në optimizimin e sinergjive dhe marrëdhënieve ndërmjet departamenteve të ndryshme, për të përmirësuar efikasitetin e biznesit brenda kuadrit të një misioni dhe vizioni të përbashkët.

**Konsumatori në qendër**

Nëpërmjet instrumenteve të avancuar të analizës, departamenti i marketingut analizon dhe interpreton shijet, nevojat dhe pikat kritike të tregut duke pasur si objektiv përmbushjen e nevojave dhe të pritshmërive të klientëve, duke vepruar më shpejt se konkurrenca.






Objektivi është që të zhvillojmë sisteme në gjendje të përpunojnë informacione dhe t'u sigurojmë klientëve tanë rezultate dhe instrumente të thjeshtë, efektiv dhe fitues. Nëpërmjet web-booking (rezervimit me internet) tonë të ri, për shembull, klientët mund të hyjnë në çdo kohë, nga çdo vend dhe nëpërmjet çfarëdolloj pajisjeje në faqen e rezervimit në internet dhe të plotësojnë procesin e rezervimit vetëm me pak klikime të thjeshta.

**Big data, algoritmet dhe inteligjenca artificiale**: investojmë në asetet fitimtare për të ardhmen e biznesit tonë.

# Sociale & Digjitale

Të vetëdijshëm për rëndësinë strategjike dhe funksionale të teknologjive dhe platformave digjitale, në Adria Ferries investojmë në burime tepër të kualifikuara për analizimin dhe administrimin e big data që rrjedhin nga përvoja e përdorimit të mediave sociale dhe të web-it të përdoruesve.











# Sponsorizime dhe evente

**Mbi velat e gjigantëve**

Deti është habitati ynë dhe misioni ynë: për këtë arsye ne mbështesim ata që, pasionin për detin, e bëjnë një mënyrë jetese. Ne sponsorizojmë profesionistët më të mëdhenj të barkave me vela në det të hapur të klasës J-70, që është aktualisht flota më e madhe në botë.

Në Kampionatin Botëror në Porto Cervo, që u zhvillua në Shtator 2017, morën pjesë 170 ekuipazhe, me pjesëmarrjen e kampionëve të shumtë olimpikë, përfshirë këtu edhe ekipin e ri Petite Terrible, të sponsorizuar nga Adria Ferries: dy herë kampion evropian, gjithmonë i pranishëm në “top 5” të kampionateve botërore në San Francisko dhe Kosta Smeralda, i dyti në kampionatin italian në vitin 2017 dhe fitues i kampionatit 2018.

# Njerëzit tanë

**Lundrojmë së bashku, në të njëjtin drejtim.**

Ne kemi investuar gjithmonë për personelin tonë, duke e shoqëruar atë në rrugëtimin e rritjes profesionale dhe njerëzore.

Ne jemi një ndërmarrje e përbërë nga njerëz që lundrojnë në të njëjtin itinerar, duke bashkëpunuar në mënyrë sinergjike, të integruar dhe të përgjegjshme dhe duke ndjekur qëllimet e përbashkëta.






# Ata thonë për ne

Ne kemi pyetur personelin tonë "Çfarë do të thotë për ta, me një fjalë, të punosh në Adria Ferries". Ja çfarë na u përgjigjën:



**ADRIA FERRIES S.p.A.**
Società unipersonale
Lungomare Vanvitelli 18
60121 Ancona, Italia
*www.adriaferries.com*

adria
ferries